

# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin qershor

## 2024

korrik 2024

Action for  
Democratic Society  
[hibrid.info](http://hibrid.info)



# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin qershor

**Publikues:** ADS/hibrid.info

Prishtinë, korrik 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



# Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përforura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

# Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë qershor 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 24-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

# Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në bazë të gjetjeve dhe trajtimit të 65 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit qershor 2024, është evidentuar se lajmet e rreme janë ato që kanë dominuar si kategori kryesore e keqinformimit me 20%. Kjo kategori pasohet nga përmbajtjet e mashtruese me 17%, clickbait me 15%, teoritë konspirative me 12% dhe dezinformatat me 11%.

Përkundër asaj se gjatë muajit të kaluar dezinformatat dhe përmbajtjet mashtruese janë kategoritë që kanë dominuar, në këtë muaj lajmet e rreme, që radhiteshin si e gjashta në muajin e kaluar, prijnë me një rritje prej 10% në raport të përgjithshëm, krahasuar me muajin paraprak (nga 10% në muajin maj 2024, në 20% në muajin qershor 2024). Kjo ka rezultuar për faktin se ka pasur një shumësi të temave nga fusha e politikës dhe sigurisë që janë vlerësuar lajm i rremë. Përderisa në muajin e kaluar (maj) përmbajtjet mashtruese prinin me 19% sa i përket kategorive keqinformuese, në këtë muaj radhiten si e dyta me një rënie të lehtë prej 2%. Sa i përket mashtrimeve, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve nga fusha e sociale janë vlerësuar me këtë kategori.

Këto dy kategori pasohen nga artikujt clickbait me 15%, të cilat kanë shënuar rritje krahasuar me muajin maj, kur radhiteshin në vend të katërt (nga 12% në muajin ma 2024, në 15% në muajin qershor 2024). Të gjithë artikujt clickbait janë publikuar në media, ku dominojnë keqinformatat nga fusha e politikës.

Artikujt clickbait pasohen nga teoritë konspirative, me një rritje të lehtë prej 2% krahasuar me muajin e kaluar (nga 10% në muajin maj 2024, në 12% në muajin qershor 2024), dhe dezinformatat të cilat kanë shënuar rënie prej 8% krahasuar me muajin maj (nga 19% në muajin maj 2024, në 11% në muajin qershor 2024).



37% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë” dhe “mashttrim”.

# Analizë e llojeve të vlerësimeve

# 1.1

## 01. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale (Facebook, TikTok). Politika dhe siguria janë fushat dominuese në të cilat më së shumti janë publikuar keqinformatat. Sa i përket temave, keqinformatat u lidhën kryesisht me zgjedhje ku pretendohet se ambasadori amerikan mbështet Bedri Hamzën për kryeministër, se LDK po shqyrton mundësinë për koalicion me PDK-në dhe sondazhe të rreme elektorale; dhe armatosjen e FSK-së ku u pretendua për dhënie të automjeteve, fluturakeve dhe helikopterëve ushtarak nga Turqia.

## 03. Clickbait

Të gjithë artikujt me tituj clickbait janë publikuar në media reale nga fusha e politikës e cila dominon, pasuar nga kronika e zezë, kultura, socialja dhe siguria. Edhe pse prinë tema e rasteve tragjike (vdekje, vrasje), edhe tema të tjera si, armatosja e FSK-së, bisedimet për Kosovën, Asociaconi i komunave me shumicë serbe, etj.

## 02. Mashtrim

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale (Facebook, TikTok). Pjesa dërrmuese e tyre ishin nga fusha e sociale, përfshirë tema të tilla si, pretendime për dhënie kredish, produkte që pretendojnë se shërojnë sëmundje të caktuara, kurse falas nga Qeveria, SMS mashtrues, ndihma financiare për shërim etj.

## 04. Teori konspirative

Pjesa dërrmuese e teorive konspirative janë publikuar në media në gjuhën serbe. Këto keqinformata ishin nga fusha e politikës dhe sigurisë përfshirë temat si, disa zhvillime në vendbanimet me shumicë serbe të cilat u interpretuan si tendencë për "spastrim etnik", kërcënim me luftë nga Albin Kurti, veriu dhe pretendime se Kurti po punon për "Shqipërinë e madhe".

## 05. Teori konspirative

Të gjitha dezinformatat u publikuan nga faqe dhe llogari në media sociale, nga fusha e sigurisë, sportit dhe politikës. Sa u përket temave, armatosja e FSK-së dhe EURO 2024 ishin temat kryesore. Dezinformata lidhur me temën për armatosjen e FSK-së ku u pretendua se “ushtria e Kosovës do të forcohet deri në shtator me 10 mijë trupa e me sisteme anti-raketore” dhe se “Kosova në vitin 2026 do të marrë donacion dy helikopterë nga SHBA-të”. Ndërsa për Euro 2024 u dezinformua se kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama është shprehur se do të jetë në stadium në përkrahje të Serbisë përballë Anglisë dhe zyrtari i Ministrisë së Sportit në Serbi dezinformoi për arrestim të shqiptarëve në Euro 2024.

## 06. Përmbajtje e paverifikuar

Keqinformatat nga kjo kategori janë publikuara në media reale (5%) dhe media sociale (3%). Këto përmbajtje ishin nga fusha e sportit dhe politikës. Pretendimet se Jose Mourinho ka folur për kombëtaren e Shqipërisë, se video-materiale të caktuara që kanë zënë vend në media dhe media sociale paraqesin tifozët e kombëtares, se Shtatorja e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut nuk është bartur në Dortmund, janë disa temat nga kampionati evropian i futbollit, Euro 2024.

---


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: manipulim i fakteve, dezinformatë/clickbait, përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë, gabim, manipulim i fakteve/mashtrim, dhe manipulim i fakteve/dezinformatë.



# Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Kampionati evropian i futbollit, Euro 2024, nisur në mes të qershorit dhe pjesëmarrja e kombëtares së Shqipërisë kanë bërë në media dhe rrjete sociale të publikohen informacione të ndryshme. Në mesin e këtyre përmbajtjeve të publikuara kishte edhe pretendime të pabazuara që ndërlidheshin me kombëtaren e Shqipërisë, me futbollistët dhe tifozët e kombëtares. Publikimi i keqinformatave lidhur me Euro 2024 ka bërë që kjo temë të dominojë gjatë muajit qershor në kategorizimin e temave për të cilat u keqinformua.

Keqinformata lidhur me spekulime të ndryshme pa fakte për furnizime me armatime të FSK-së, përfshirë këtu edhe artileri të rëndë (helikopter, tank, aeroplan) janë përfshirë në temat për të cilat më së shumti u keqinformua gjatë qershorit. Edhe gjatë këtij muaji janë publikuar disa dezinformata dhe lajme të rreme lidhur me armatosjen, duke e bërë këtë temë të radhitet si e dyta për nga numri i keqinformimeve.

Gjatë muajit qershor, disa incidente që ndodhën në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë u përdorën nga kanale të caktuara për të krijuar teori konspirative rreth autorëve dhe qëllimeve të këtyre veprave, pa ofruar fakte konkrete.

Në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të gjetura gjatë këtij muaji, janë trajtuar edhe keqinformata lidhur me raste tragjike (vdekje e vrasje) në media në gjuhën shqipe, kërcënim me luftë (nga Kurti, publikuar në media në gjuhën serbe) dhe sondazhe elektorale.



46% e temave kryesore janë për Euro 2024, armatosja e FSK-së, zgjedhjet, vendbanimet me shumicë serbe, raste tragjike, kërcënim me luftë.

# Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

## 2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

### 01. Euro 2024

Një pjesë e keqinformatave nga kampionati evropian i futbollit, Euro 2024, nga fusha e sportit u publikuan në media sociale (Facebook dhe TikTok), ndërsa pjesa tjetër në media reale. Në media sociale u publikuan dezinformatat me pretendimet se selektori i Kroacisë, Zlatko Daliç, ka lavdëruar kombëtaren e Shqipërisë, se Rama do të jetë në stadium në përkrahje të Serbisë përballë Anglisë, e një zyrtari i Ministrisë së Sportit në Serbi dezinformoi për arrestim të shqiptarëve në Euro 2024. Manipulim i fakteve u publikuan me pretendimet se Rron Gjinovci ka shprehur publikisht përkrahjen për Serbinë përballë Sllovenisë në Euro 2024 e se Asani dhe Ramadani janë tallur me Hysajn pas ndeshjes kundër Italisë. Në media sociale u publikuan edhe përmbajtja e gjeneruar me inteligjencë artificiale me pretendimin se aktori, Arnold Schwarzenegger, ka lavdëruar kombëtaren shqiptare të futbollit, lajmi i rremë se ish-futbollisti gjerman Lotar Matthaus ka folur për kombëtaren shqiptare të futbollit dhe përmbajtja e paverifikuar e video-materalit me pretendimin se paraqet tifozët e kombëtares në Dortmund. Ndërsa në media reale u publikuan përmbajtjet e paverifikuara me pretendimet se Papa Françesku e ka përsëndetur kombëtaren shqiptare me simbolin e shqiptonjës dykrenare, se Jose Mourinho ka shkruar në platformën “X” për Kombëtaren e Shqipërisë, Shtatorja e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut është bartur në Dortmund, se një video-materal i publikuar paraqet tifozët e kombëtares para ndeshjes me Italinë në Dortmund.

### 02. Aramosja e FSK-së

Pothuajse të gjitha përmbajtjet që ndërlidhen me armatosjen e FSK-së janë publikuar në media sociale. Këto përmbajtjet u vlerësuan si lajm i rremë dhe dezinformatë. Lajm i rremë u vlerësuan pretendimet e publikuara në media sociale se Turqia i ka dhuruar automjete ushtarake Kosovës, se do ta furnizojë Kosovën me helikopterë “T129 ATAK”, se Kosova dhe Turqia kanë nënshkruar marrëveshje për fluturaken luftarake, Kizilelma. Ndërsa dezinformatë u vlerësuan pretendimet se “ushtria e Kosovës do të forcohet deri në shtator me 10 mijë trupa e me sisteme anti-raketore”, se Kosova në vitin 2026 do të marrë donacion dy helikopterë nga SHBA-të.

### 03. Vendbanimet me shumicë serbe

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese që ndërlidheshin me tematikën e zgjedhjeve janë vlerësuar si lajm i rremë dhe janë publikuar kryesisht në media sociale. Në lajmet e rreme të publikura në media sociale u pretendua se ambasadori amerikan mbështet Bedri Hamzën për kryeministër, se LDK-ja po shqyrton mundësinë për koalicion me PDK-në dhe publikimi i një sondazhi të manipuluar për zgjedhjet e ardhshme në Kosovë. Në media është publikuar një artikull me pretendimin e rremë se gjatë muajit qershor është realizuar një sondazh nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), ku pasqyron përkrahjen e qytetarëve për partitë politike në Kosovë.

### 04. Raste tragjike


Përmbajtjet keqinformuese që ndërlidhen me disa ngjarje në vendbanimet me shumicë serbe dhe komunitetin serb në Kosovë janë publikuar në media reale në gjuhën serbe. Këto përmbajtje u vlerësuan si teori konspirative, me pretendimet se Qeveria Kurti ka nisur “fazën e fundit të mbylljes së gjithçkaje serbe” në Kosovë, se veprimet gjyqësore të Kosovës dhe mbishkrimet “Albania” në Shushicë ndërlidhen “spastrimin etnik” të serbëve.

## Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit qershor del se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës.

### FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Fusha e politikës, gjatë muajit të kaluar (maj) është radhitur si e dyta me 28%, ndërsa gjatë këtij muaji (qershor) me rritje në përqindje radhitet si e para me 34%. Keqinformatat nga politika kryesisht u vlerësuan si lajm i rremë, clickbait, teori konspirative dhe manipulim i fakteve. Në fushën e politikës u keqinformua për shumëllojshmëri temash prej të cilave mbizotërojnë përmbajtjet e ndërlidhur me zgjedhje, vendbanimet me shumicë serbe, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, bisedime për Kosovën, BE dhe Kosova, njohja e Kosovës etj.

Politika pasohet nga fusha e sigurisë, sociale dhe sporti të cilat ndajnë përqindje të njëjtë gjatë këtij muaji. Siguria, e cila gjatë muajit të kaluar (maj) është radhitur si e para me 29%, gjatë muajit qershor keqinformatat nga kjo fushë kanë pësuar rënie prej 11% në raportin e përgjithshëm duke bërë që kjo fushë të radhitet si e dyta me 18%. Nga fusha e sigurisë dominuan përmbajtjet e vlerësuara si dezinformatë, teori konspirative dhe lajm i rremë. Sa u përket temave, armatosja e FSK-së dominon përfshirë këtu edhe tema si, kërcënime me luftë, lufta në Ukrainë, veriu, konflikti Izrael-Hezbollah etj.

Fusha e sociale, ka pësuar rënie prej 5% krahasuar me muajin paraprak, duke bërë që kjo fushë të radhitet e treta (me përqindje të njëjtë me vendin e dytë). Në kuadër të temave sociale dominojnë përmbajtje mashtruese për dhënie kredish, produkte për të cilat pretendohet shërojnë sëmundje të caktuara, kurse falas nga Qeveria, shërbime mjekësore, SMS mashtrues, ndihmë financiare për shërim etj.

Për shkak të kampionatit evropian të futbollit, Euro 2024, përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sportit kanë shënuar rritje prej 10% në krahasim me muajin paraprak (nga 8% sa ishte në maj, në 18% në qershor). Të gjitha keqinformatat lidhur me Euro 2024 u vlerësuan përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë, mashtrim, lajm i rremë, dezinformatë/clickbait, përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë, manipulim i fakteve/mashtrim dhe manipulim i fakteve.

---



88% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sigurisë, sociale dhe sportit.


# 4

## Llojet e publikuesve

Bazuar në gjetjet dhe trajtimet e përmbajtjeve keqinformuese, përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga faqe dhe llogari në media sociale vazhdojnë të dominojnë edhe gjatë qershorit. Krahasuar me muajin paraprak (maj), keqinformatat e publikuara në media sociale gjatë këtij muaji, kanë pësuar rënie prej 13% (nga 67% në maj në 54% në muajin qershor 2024). Të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe dezinformatat, dhe një pjesë e konsiderueshme e lajmeve të rreme janë publikuar në media sociale, duke bërë kështu që keqinformatat e publikuara në media sociale të dominojnë edhe gjatë këtij muaji.

Keqinformimet e identifikuar dhe trajtuara gjatë këtij muaji, të cilat janë publikuar në media reale (portale informative), kanë shënuar rritje prej 13% me përmbajtjet e publikuara gjatë muajit të kaluar (nga 32% në maj në 45% në muajin qershor 2024). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se te gjithë artikuj me tituj clickbait (media në gjuhën shqipe) dhe teoritë konspirative (media në gjuhën serbe) janë publikuar në media reale.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES  
TË PUBLIKUESVE ME  
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



99% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (54%) dhe në mediat reale (45%).

# 5

## Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Publikimet në gjuhën serbe  
14%



Publikimet në gjuhën shqipe  
86%

Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit qershor 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 86% të rasteve të trajtuara.

Gjatë këtij muaji, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar gjithashtu përmbajtje në gjuhën serbe (14%), të cilat ndërlidheshin me zhvillimet në Kosovë.

# Analiza e artikujve të kësaj kategorie

## 5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

### 01. Publikimet në gjuhën shqipe

Pak më shumë se gjysma e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale (52%), ndërsa pjesa tjetër janë publikuar në mediat reale (34%) dhe SMS (1%). Pothuajse të gjitha lajmet e rreme (18%), përmbajtjet mashtruese (15%), dhe dezinformatat (9%) janë publikuar në media sociale. Ndërsa në media reale janë publikuar të gjithë artikujt clickbait (15%) dhe një pjesë e përmbajtjeve të paverifikuara (5%), gabimeve (3%), manipulim i fakteve (3%). Përderisa në media sociale prijnë përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sociale (14%), politika (12%), sport (11%) dhe siguri (11%), në media reale dominon politika (17%), sporti (6%) dhe kronika e zezë (5%).

### 02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformues në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe dhe një pjesë në media sociale. Në media u publikuan përmbajtje keqinformuese nga fusha e politikës, sigurisë dhe sociale dhe u vlerësuan si teori konspirative dhe manipulim i fakteve/dezinformatë. Ndërsa në media sociale keqinformatat nga fusha e sportit. Manipulim i fakteve/dezinformatë u vlerësua manipulimi i mediave serbe me komentet e Dua Lipës në Pula të Kroacisë, ndërsa teori konspirative u vlerësuan pretendimet e pabaza nga fusha e sigurisë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po kërcënon me luftë, po i përgatit fëmijët për luftë, po i arreston serbët për nxitje të tensioneve, dhe nga fusha e politikës, ndërlidhja e incidenteve dhe mbishkrimeve në vendbanimet me shumicë, për të cilat nuk dihen kryesit dhe qëllimi, me narrativën se qëllimi është “spastrimi etnik” i serbëve.



# 6

## Llojet e mediave sociale


Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Në bazë të monitorimit të bërë gjatë muajit qershor, përmbajtjet keqinformuese në mediat sociale janë publikuar në Facebook me 51%, ndërsa 46% në TikTok, të ndjekur nga X me 3%.

Ashtu si në muajt paraprak (maj, prill) edhe gjatë këtij muaji (qershor) vazhdojnë të mbizotërojnë përmbajtjet keqinformuese të publikuara në Facebook, edhe pse më një rënie të lehtë prej 6% (nga 57% në maj në 51% në qershor 2024).

Ndërkohë, keqinformimet e gjetura dhe të trajtuara në median sociale TikTok kanë shënuar rritje të konsiderueshme prej 13% (nga 33% në maj 2024 në 46% në qershor 2024). Ndërsa gjatë këtij muaji është gjetur përmbajtje keqinformuese në platformën X.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




# Llojet e publikuesve në mediat sociale

## 6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në bazë përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale për muajin qershor 2024, më së shumti u publikuan nga faqe (37%) dhe llogari (9%) në Facebook, pasuar nga llogari në TikTok (46%). Në muajin maj, 8% e keqinformatave ishin publikuar nga media dhe grupe (3%) në Facebook dhe llogari (3%) në platformën X.



# 6.2

## Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

### 01. Facebook

Përmbajtjet mashtruese (23%), dezinformatat (11%) dhe lajmet e rreme (9%) janë tri kategoritë kryesore me të cilat u vlerësuan keqinformatat e publikuara në Facebook. Socialja (23%) dhe sporti (14%) janë dy fushat kryesore, për të cilat u keqinformua gjatë muajit qershor në Facebook. Temat kryesore për të cilat u keqinformuar më së shumti në Facebook janë Euro 2024 dhe publikimet mashtruese për produkte shëruese dhe dhënie kredish.

### 03. X

Në platformën X është publikuar një dezinformatë, në të cilën zyrtari i Ministrisë së Sportit në Serbi dezinformonte për arrestim të shqiptarëve në Euro 2024.


### 02. TikTok

Lajmet e rreme (26%), dezinformata (6%), përmbajtjet e paverifikuara (6%) dhe ato mashtruese (6%) janë kategoritë që kanë dominuar në vlerësimin e përmbajtjeve keqinformuese. Sa u përket fushave, politika (17%) dhe siguria (14%) janë dy fushat për të cilat u keqinformua më së shumti në platformën TikTok. Armatosja e FSK-së dhe Euro 2024 janë dy temat për të cilat u keqinformua më së shumti në TikTok.

# Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

## RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Bazuar në 65 përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë muajit qershor 2024, rezulton se në 13 prej tyre janë përmendur 9 institucione të ndryshme. Në mesin e këtyre institucioneve të përmendura mbizotërojnë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.


Forca e Sigurisë së Kosovës është përmendur në katër përmbajtje keqinformuese, konkretisht në lajme të rreme dhe dezinformata të publikuara në media sociale. Ky institucion u përfol në pretendime të rreme lidhur me armatosjen e këtij institucioni me artileri të rëndë ushtarake.

Zyra për Kosovën në Qeverinë është përfolur në dy përmbajtje keqinformuese të publikuara gjatë muajit qershor. Kjo Zyrë është përfolur në teoritë konspirative të publikuara nga mediat në gjuhën serbe, të cilat, duke iu referuar komunikatave të kësaj zyre, disa zhvillime në vendbanimet me shumicë serbe dhe në veri të Kosovës i interpretonin si të motivuara etnikisht.

Të gjitha institucionet tjera janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara. Bashkimi Evropian (BE) është përfolur në pretendimin pa fakte për publikimin e një raporti që e bën përgjegjëse Serbinë për sulmin në Banjskë. Organizata amerikane The National Democratic Institute (NDI) u përfol në lajmin e

remë të publikuar në media në gjuhën shqipe me pretendimin për një sondazh parazgjedhor. Qeveria u përfol në përmbajtjen mashtruese të publikuar në media sociale me pretendimin se do të ofrojë kurse falas në gjuhën angleze. Programi Kërkimor Aktiv Auroral me frekuencë të lartë, i njohur si HAARP është përfolur në teorinë konspirative të publikuar në media sociale me pretendimin se ndryshon klimën, krijon stuhi, tërmet e vullkan, si dhe krijon tharje të tokës. LDK/PDK janë përfolur në një përmbajtje keqinformuese të publikuar në media sociale me pretendimin e remë se LDK-ja po shqyrton mundësinë për koalicion me PDK-në. Ministria e Financave u përfol në një përmbajtje mashtruese të publikuar në media sociale me pretendimin se kjo ministri ofron kredi pa interes për personat mbi 35 vjeç.

## RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFLUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti është figura më e përfolur (11 keqinformata) në kontekst me personalitete tjera në 33 keqinformata në të cilat janë përfolur personalitetet. Kurti u përfol në teoritë konspirative të publikuara nga mediat në gjuhën serbe me pretendimet se Kurti po kërkon luftë, po i përgatitë fëmijët për luftë, po i arreston serbët në Kosovë për nxitje tensionesh dhe “spastrim etnik”, po punon për “Shqipërinë e madhe”. Ai u përfol edhe në lajmin e remë të publikuara në media sociale me pretendimin se ka deklaruar se Kosova dhe Turqia kanë nënshkruar marrëveshje për fluturaken luftarake, Kizilelma, si dhe në artikullin clickbait të publikuara në media në gjuhën shqipe lidhur me incizimet Kusari-Radoçiq.

Kurti u përfol edhe në kontekst me personalitete tjera. Ai përfol me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku në artikullin clickbait të publikuar në media me pretendimin se kryeministri Rama, po e përdor si vegël kryetarin e LDK-së, për ta sulmuar kryeministrin Kurti. Ai u përfol edhe në pretendimin e rremë të publikuar në media sociale se Ismail Kadare e cilëson Kurtin si “vrasës të shpresës në Kosovë”. Kurti u përfol edhe në artikullin clickbait të publikuar në media me pretendimin në titull se është arritur marrëveshje me presidentin e Turqia, Recep Tayyip Erdogan, për furnizim me armë. Kryeministri u përfol edhe në dezinformatën e publikuar në media në kontekst me emisarin e BE-së, Miroslav Lajçak e që u pretendua se Lajçak ka deklaruar se “Kurti pranon draft-statutin e Asociacionit”.

Personaliteti i dytë më i përfolur, kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza. Ai u përfol në lajmet e rreme të publikuara në media sociale me pretendimet rreme se Hamza ka premtuar se do t'i rritë pensionet për veteranët e luftës deri në 1500 euro, si dhe se është shprehur kundër idesë për hapjen e Urës së Ibrit. Hamza u përfol në kontekst me ambasadorin e SHBA-ve, Jeffrey Hovenier, në një lajm të rremë të publikuar në media sociale kur pretendohet rrejshëm se Hovenier mbështet Bedri Hamzën për kryeministër.

# Metodologjia

---

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 qershor 2024, në të cilën janë trajtuar 65 përmbajtje keqinformuese.

---

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit qershor 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

# Përfundime

---

Euro 2024 dhe pjesëmarrja e kombëtares së Shqipërisë çuan në një rritje të informatave të ndryshme, përfshirë pretendime të pabazuara rreth ekipit, lojtarëve dhe tifozëve, duke e bërë këtë temë dominuese për keqinformim gjatë qershorit. Spekulumet për furnizimin me armatime të FSK-së, përfshirë artileri të rëndë, gjithashtu renditen lart ndër temat më të keqinformuara. Po ashtu, incidente në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë u përdorën nga kanale të caktuara për të krijuar teori konspirative pa ofruar fakte konkrete.

---

Gjatë qershorit, politika u rendit e para me 34% të keqinformimeve, kryesisht për lajme të rreme, clickbait, teori konspirative dhe manipulim të fakteve, duke përfshirë tema si zgjedhjet dhe Asociacioni i Komunave me shumicë serbe. Siguria, që në maj ishte e para me 29%, ra në 18% në qershor, me përmbajtje kryesisht rreth armatimit të FSK-së dhe kërcënimeve me luftë. Për shkak të Euro 2024, keqinformimet në fushën e sportit u rritën nga 8% në maj në 18% në qershor, kryesisht lidhur me përmbajtje të paverifikuara dhe dezinformata.

---

Bazuar në gjetjet dhe trajtimet e përmbajtjeve keqinformuese, përmbajtjet nga faqet dhe llogaritë në media sociale vazhduan të dominojnë edhe gjatë qershorit, megjithëse kanë pësuar një rënie prej 13% krahasuar me majin (nga 67% në 54%). Keqinformimet e publikuara në mediat reale, si portalet informative, shënuan një rritje prej 13% (nga 32% në maj në 45% në qershor), kryesisht për shkak të artikujve clickbait dhe teorive konspirative. Në qershor, keqinformimet në media sociale u publikuan kryesisht në Facebook (51%), TikTok (46%) dhe X (3%).

---



Bazuar në 65 përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë muajit qershor 2024, rezulton se në 13 prej tyre janë përmendur 9 institucione të ndryshme, me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Zyrën për Kosovën në Qeverinë e Serbisë që mbizotërojnë. FSK është përmendur në katër përmbajtje keqinformuese, përfshirë lajme të rreme dhe dezinformata për armatosjen e saj, ndërsa Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë është përfolur në dy përmbajtje, kryesisht në teori konspirative të publikuara nga mediat serbe që i interpretonin zhvillimet në vendbanimet me shumicë serbe dhe në veri të Kosovës si të motivuara etnikisht.

---

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në 33 keqinformata që lidhen me personalitete, me 11 raste. Ai është përfolur në teori konspirative të publikuara nga mediat serbe, duke përfshirë pretendimet se po kërkon luftë, po i arreston serbët për të nxitur tensione dhe po punon për "Shqipërinë e madhe". Kurti është përmendur gjithashtu në lajme të rreme dhe artikuj clickbait, duke përfshirë pretendimet për marrëveshje ushtarake me Turqinë dhe manipulime politike me figura të tjera, si Edi Rama dhe Lumir Abdixhiku. Personaliteti i dytë më i përfolur është kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza. Ai është përmendur në lajme të rreme në media sociale, me pretendime se ka premtuar rritje të pensioneve për veteranët dhe kundërshtimin e hapjes së Urës së Ibrit. Hamza është përfolur edhe në kontekstin e një lajmi të rremë ku pretendonte mbështetje nga ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier për të qenë kryeministër.

HIBRIDO.INFO